



Ledian Memushaj ka shenuar nje tjeter gol per skuadren e Karpit. Vlonjati po ben nje super sezon ne Serine B italiane dhe kjo e ka bere qe shume skuadra ta ndjekin me interes. Mesfushori shqiptar shenoi golin e barazimit ne ndeshjen perballe Lancianos dhe me pas skuadra e Karpit arriti te fitonte ne transferte per te bere nje tjeter hap te rendesishem ne tabelen e klasifikimit ku tani qendron ne mesin e tabeles me synimin per te kapur zonen e play-offit. Memushaj shenoi golin e trete per skuadren e Karprit dhe tani eshte serish nje lojtar per tu patur ne vemendje nga Xhani De Biazi. Vlonjati eshte grumbulluar me pare ne kombetare dhe pritet te rikthehet serish ne vitin 2014.